



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	20.03.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Marjan PERLASKA Drejtor i Departamentit të Prokurimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit
CC:	znj. Mrika TAHIRI Zëvendës Drejtoreshë Menaxhuese në Agjencinë Kosovare të Privatizimit
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur për Tenderin me titull "Shërbimet e sigurimit fizik për hapësirat e AKP-së dhe të Ndërmarrjeve shoqërore nën administrimin e AKP-së "

I nderuari z. PERLASKA ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me tenderin " Shërbimet e sigurimit fizik për hapësirat e AKP-së dhe të Ndërmarrjeve shoqërore nën administrimin e AKP-së ", me nr. të prokurimit: 239-14-001-211 Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Kërkohet nga ju si autoritet kontraktues (në tekstin e mëtejme A.K), që t'i ndërmerri të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin "Shërbimet e sigurimit fizik për hapësirat e AKP-së dhe të Ndërmarrjeve shoqërore nën administrimin e AKP-së" në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr.04 – I/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Departamenti i Prokurimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka përgatitë “Njoftimin për Kontratë” me titull “Shërbimet e sigurimit fizik për hapësirat e AKP-së dhe të Ndërmarrjeve shoqërore nën administrimin e AKP-së“, me nr. të prokurimit: 239-14-001-211, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.11.02.2014, në Procedurë të Hapur. Agjencia kundër Korrupsionit, përmes Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si rast për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit në “Njoftimin për Kontratë” dhe “Dosjen e Tenderit”, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në disa të dhëna që nuk janë në pajtueshmëri të plotë me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik i cili është i zbatueshëm në Republikën e Kosovës.

Në “Njoftimin për Kontratë” të publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 11.02.2014, tek pika IV.2 e rubrikës “Kriteret për dhënie”, si kriter për dhënie të kontratës është caktuar Tenderi ekonomikisht më i favorshëm, si nën kriterë janë caktuar:

1) Çmimi i cili është peshuar me 70% ,

2) Numri i punëtorëve i cili do të merret në vlerësim vetëm nëse lista e punëtorëve nga operatori ekonomik për periudhën e vitit 2012, 2013 është e dorëzuar/vërtetuar nga Trusti i kursimeve pensionale ose nga Administrata Tatimore. Ku pikët për këtë nën kriter do të llogariten si në vijim:

100- deri në 200 punëtor - 10 pikë,

200- deri në 300 punëtor - 15 pikë,

ndërsa, mbi 300 punëtor - 20 pikë,

pesha për këtë nën kriter është caktuar 20% .

3) Tek nën kriteri i tretë është kërkuar që për personelin kryesor (Menaxherin e Kompanisë) të ofrohet diplomë mbi dëshminë e kualifikimit universitar, ndërsa pesha për këtë nën kriter është caktuar 10%.

Në “Dosjen e Tenderit” e cila është përgatitur nga A.K. janë përshkruar të njëjtat nënkriterë me përjashtim tek nënkriteri 2 ku është caktuar që, pikët e tenderit llogariten si në vijim:

100- deri në 200 punëtor - 5 pikë,

200- deri në 300 punëtor - 10 pikë,

ndërsa, mbi 300 punëtor - 15 pikë,

pesha për këtë nën kriter është caktuar 20% .

Gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit të Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit, konstatohet qartë se lidhur me nën kriterin 2 tek pjesa e pikëve ka dallime , përkatësisht pikët që janë vendosur tek ky nën kriter janë të ndryshme çka paraqet mospërputhje në mes Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit, i ka caktuar nën kriteret 2 dhe 3, si Kriteret për dhënie të Kontratës, A.K duhet të bëjë një dallim të qartë në mes kriterëve të përzgjedhjes dhe kriterëve për dhënie të kontratës, sipas legjislacionit në fuqi për Prokurimin Publik, kriteret e përzgjedhjes nuk mund të përdoren në asnjë mënyrë si kriteret për



dhënien e Kontratës, andaj këto kritere do duhej të ishin të përcaktuara si kritere minimale për kualifikim e në asnjë mënyrë të përdorën si kritere për dhënie të kontratës.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, me nenin 23 dhe nenin 25 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

